



## Anatomia e ekstremizmit në fe

### Description

#### Hatem El-Auni

Favorizimi i ashpërsisë dhe ekstremizmit në fe si edhe simpatizimi ndaj tij shfaqet në forma të ndryshme, dhe ndërmjet tyre përmendim:

#### 1. Falja e gabimit të dikujt që shpreh një qëndrim të ashpër në fe.

(a) Kur dikush gabon në të shpallurit e diçkaje haram (përgjigja e zakonshme në këtë rast është): Kjo është thjesht ixhtihad i tij (Ky është thjesht ixhtihad, o vëlla!) dhe si i tillë personi nëse është i saktë në atë që thotë ka dy sevape ndërsa nëse është i pasaktë ka vetëm një sevap.

(b) Kur dikush gabon në të konsideruarit e diçkaje të lejuar (përgjigja e zakonshme është): Ai është xhahil (inorant), i dobët në fe, i mundur psikologjikisht, i ndikuar nga Perëndimi... madje nëse çështja në fjalë ka të bëjë me normat ligjore në lidhje me gratë, atëherë ai konsiderohet si një person që nuk ka xhelozi.

#### 2. Interpretimi i qëllimeve (nijetit) të atyre që janë të ashpër dhe ekstremistë në fe.

Sipas tyre ashpërsia në fe lind nga intensiteti i devotshmërisë së personit që shfaq qëndrime të ashpra, si edhe nga masa e shtuar në fetari!! Përndryshe, përse do të shfaqte ai ashpërsi në qëndrimet e tij?! Megjithatë, ky person (që e justifikon në këtë mënyrë atë që shfaq qëndrime të ashpra në fe) duhet të tregonte hezitim përballë ashpërsisë në fe në të njëjtën mënyrë siç tregon ngurrim karshi lehtësimit në fe. Sepse, të dyja qasjet përbëjnë një përpjekje për të korrigjuar Sheriatin dhe një dalje nga kufijtë e vendosur në të. Fetaria e tepërt është njësoj si fetaria e pakët, që të dyja janë në kundërshtim me vullnetin e Allahut të Lartësuar dhe të urryera nga Ai. Havarixhët nuk humbën (shkuan në dalalet) nga rruga e drejtë si pasojë e mungesës së fetarisë por si pasojë e fetarisë së tepruar!!

### **3. Mveshja e cilësive të neveritshme/të pështira lehtësimit në fe dhe specifikimin e tij vetëm te këto cilësi, ndërkohë që këto cilësi duhet t'i aplikohen edhe ashpërsisë në fe.**

(Shpesh njerëzit e cilësojnë) atë që lehtëson/lëshon në fe si të devijuar (të larguar nga norma), ndërkohë që edhe ai që tregohet i ashpër në fe devijon dhe largohet nga normat ligjore, apo hukmet e Zotit, njësoj si ai që tregohet jo strikt në fe. Shpesh ai që lëshon/lehtëson në fe konsiderohet si dikush që është duke tretur/holluar normat e Zotit, ndërkohë që edhe ai që ashpëron/e tepron në fe vepron në të njëjtën mënyrë (d.m.th. shkrin/çbën normat e Zotit). Ai që lëshon/lehtëson në fe konsiderohet i mundur/frustruar psikologjikisht përpara presioneve të realitetit. Megjithëkëtë, edhe ashpërsia në fe përbën disfatizëm përballë realitetit, njësoj si lëshimi në fe. Vetëm se, arratisja përballë presioneve të realitetit ndonjëherë ndodh duke u zbrapsur e herë të tjera duke shkuar përpara. Çdokush që braktis fushëbetejën, d.m.th. luftën e përpjekjes, apo xhihadin, me veten në mes të një realiteti të ashpër, qoftë përmes lëshimit, qoftë ashpërsisë në fe, në të vërtetë është mundur dhe është arratisur nga fushëbeteja.

### **4. Kufizimi i devotshmërisë tek ashpërsia në fe dhe shndërrimi i haramit në sinonim të devotshmërisë**

Të shmangurit nga të cilësuarit e diçkaje si haram, në mos qoftë më parësore sesa të ruajturit prej mosrënies në haram, patjetër që është e njëjlojtë me të.

(Kjo për disa arsye):

1. Baza (asli) në lidhje me çdo gjë, përveç adhurimeve, është lejueshmëria. Ndërsa ndalesa është një përjashtim nga regulli.
2. Parimi i pafajësisë deri sa të provohet e kundërta (bera'at el-dhimme) është parim themelor dhe çdo shmangie prej kësaj norme ka nevojë për argument, apo delil.
3. Baza (asli) është justifikimi i veprimit të dikujt me padituri (xhehl) dhe një gjë e tillë pengon nga të atribuuarit faj apo kufër dikujt.
4. Sheriati ka ardhur për t'i lehtësuar gjërat dhe për të eliminuar vështirësitë, problemet dhe sikletet.
5. Sheriati ka zbritur për të bërë të mundur realizimin e lumturisë njerëzore dhe jo për të kundërtën.

Këto, si edhe principe dhe parime universale të tjera islame, e bëjnë të detyrueshme që largimi/ruajtja nga ashpërsia në fe të jetë më parësore se sa përpjekja për të arritur devotshmërinë përmes ashpërsisë apo për hir të saj.

### **5. Hamendësimi se ruajtja e normave të Sheriatit nuk mund të arrihet vetëm se përmes bllokimit të mjeteve që të dërgojnë tek e keqja (sedd el-dherieh) si edhe bindja se ekzistojnë mjete që duhen ndaluar. I gjithë ky qëndrim vjen si pasojë e mbështetjes në hamendësime dhe në arsyetime të dobëta.**

(Pjesë e keqarsyetimit në këtë çështje është bindja se) bllokimi i mjeteve që dërgojnë tek e keqja nuk mund të realizohet vetëm se përmes ndalesës. Një mendim i tillë nuk merr parasysh faktin se një

synim i tillë mund të përmbushet edhe përmes lejimit (jo vetëm ndalesës)! Kjo arrihet përmes zgjerimit të fushës së lejueshmërisë dhe bërjes me dije njerëzve se hallalli e bën të panevojshëm nevojën për haram dhe se përmes hallallit ata mund të përmbushin gjithçka prej synimeve të tyre që mendojnë se mund të përmbushen vetëm përmes haramit, qofshin këto arritja e kënaqësisë, grumbullimi i pasurisë, apo përmbushja e ndonjë të mirë të përgjithshme (maslaha). Ekzagjerimi (mubelagha) në përdorimin e instrumentit sheriatik të bllokimit të mjeteve që të dërgojnë tek e keqja, përjetësimi (te'bid) i normave të saj dhe mungesa e çdo përpjekjeje për ta kthyer normën (hukm) sheriatike tek origjina e saj, d.m.th. lejueshmëria, vjen si pasojë e këqkuptimit në së paku katër aspekte:

1. Mendimi i keq (su'u dhan) në lidhje me Sheriatin dhe bindja se ai nuk mjafton për realizimin e dobive fetare (dinijeh) dhe atyre mundane, apo të dynjasë (dun'jauijeh).
2. Në një qasje të tillë gjendet një xhelozë e tepruar për Sheriatin dhe një përpjekje për të shkuar përtej asaj që Zoti dhe i Dërguari i Tij kanë shprehur.
3. Një qasje të tillë përbën një kundërshtim ndaj realitetit të qendrueshmërisë së Sheriatit dhe gjithëpërfshirshmërisë së tij.
4. Një qëndrim i tillë përbën mendim të keq (su'u dhan) ndaj myslimanëve si dhe përbën një edukim për të kultivuar një mendim të tillë të keq për myslimanët e tjerë. Duket sikur ky qëndrim që ndalon dhe bën haram gjithçka, dhe që në fakt zëvendëson hukmin fillestar të Zotit, është e vetmja gjë që i pengon njerëzit nga të devijuarit prej normave sheriatike.

## **6. Trashja e gjynaheve përtej peshës së tyre reale.**

Në këtë mënyrë, gjynahet e vogla shndërrohen në të mëdha dhe shkallët e disa gjynaheve të mëdha (të marra në analizë) zmadhohen së tepërmi brenda rendit të gjynaheve të mëdha. Për të mos folur pastaj për nxjerrjen e njerëzve prej feje (tekfiri) për shkak se kanë vepruar këto gjynahe të mëdha. Kemi dëgjuar njerëz që e cilësojnë duhanin si më të shëmtuar se pirja e verës dhe si shkatërruesin e pesë domosdoshmërive (darurijat) kryesore për të cilat ka zbritur Sheriati, d.m.th. ruajtja e fesë, e jetës, e intelektit, e pasardhësve dhe e pasurisë. Kur vjen puna tek mjekrra disa tipa nuk kanë asnjë dyshim se heqja e saj është gjynah i madh. Pavarësisht se një veprim i tillë konsiderohet mekruh (i papëlqyeshëm) tek shafiitë dhe ai madje nuk futet fare tek veprimet e ndaluara (haram). Të njëjtin qëndrim kanë mbajtur edhe një grup dijetarësh prej malikive dhe hanbelive. Këta dijetarë kanë përgjigje të forta dhe të kënaqshme ndaj argumenteve të sjella nga ata që e konsiderojnë haram heqjen e mjekrrës. Kjo për sa i përket atyre që e konsiderojnë heqjen e mjekrrës si të ndaluar, ndërsa pohimi se një veprim i tillë është gjynah i madh nëse përsëritet dhe shfaqet në publik, një mendim i tillë është thjesht fryt i injorancës (xhehl). Ndërsa për sa i përket mbajtjes së pantallonave deri poshtë kyçit (disa shprehen) se një veprim i tillë është haram i madh pa asnjë mëdyshje. Kjo pavarësisht faktit që shumica e dijetarëve e ka konsideruar një veprim të tillë mekruh (të papëlqyeshëm). Mekruhu barazohet me haramin?! Tek libri im "*Tekfir Ehl el-Shehadetejn*" (Bërja tekfir e atyre që thonë shehadetin) e kam sqaruar problemin në menhexhin (metodologjinë) e të bërit tekfir që gjendet tek këta njerëz dhe kam sqaruar qëndrimin e saktë ndaj kësaj çështjeje.

## **7. Zvogëlimi i numrit të veprimeve që konsiderohen të papëlqyeshme (mekruh) në favor të të ndaluarave (haram) dhe zvogëlimi i të rekomandueshmeve (mustehab) në favor të të obligueshmeve (uaxhib)**

Në fetvatë e disa njerëzve nuk e dëgjon fjalën e papëlqyeshme (mekruh) sepse veprimet e

papëlqyeshme janë shndërruar në haram. Në pjesën më të madhe të rasteve, të rekomandueshmet janë shndërruar në të detyrueshme. Argumentet e ofruara prej tyre për të shndërruar gjithcka në haram dhe vaxhib janë të tilla që do të bënin të gajasej së qeshuri madje edhe personi që po mban zi, kurse dijetarin do ta bënin të qante.

#### **8. Parapëlqimi i kapjes pas opinionit juridik të vetmuar/anormal (shadh) ose pas vetëm një mendimi të izoluar juridik që e konsideron një veprim të caktuar haram, si edhe mospëlqimi i mendimeve juridike që e konsiderojnë të lejuar kryerjen e diçkaje**

Nëse për një mendim të caktuar një dijetar veçohet me përqafimin e një mendimi të ashpër, qoftë ky mendim apo iktilaf i pranuar ose jo, ekstremistët në fe priren drejt përvetësimit të një mendimi të tillë dhe madje edhe pohojnë se ata i kanë paraprirë këtij dijetari në ndalimin apo ashpërsinë në lidhje me çështjen në fjalë. Por, nëse ndonjë prej dijetarëve mban qëndrim që e lejon apo lehtëson kryerjen e veprimit në fjalë, ata e kundërshtojnë atë po të njëjtët njerëz i shpallin atij luftë dhe e kritikojnë ashpër... P.sh. mendimi se falja e namazit me xhemat në xhami është farz ajn (obligim individual) për çdo person është një mendim që nuk e ka shprehur asnjëri prej themeluesve të katër medhhebeve, apo shkollave juridike Islame. Katër medhhebet e kanë konsideruar faljen me xhemat në xhami, ose të rekomandueshme ose farz kifajeh (obligim komunitar). Disa njerëz kanë përvetësuar mendimin e kundërt me atë të katër medhhebeve dhe e kanë konsideruar të obligueshëm faljen e namazit me xhemat në xhami dhe farz ajn. Por problemi nuk qëndron këtu (ndonëse ky iktilaf [mendim i ndryshëm] mund të konsiderohet vërtet një problem në vetvete) por problemi qëndron tek akuza kundrejt verdiktit juridik të katër medhhebeve dhe mospëlqimi ndaj tij. Këta njerëz i përshkruajnë dijetarët që mbrojnë mendimin e katër medhhebeve si neglizhentë të namazit me xhemat dhe si edhe urryes/kundërshtues të simboleve të Islamit dhe i paraqesin ata si njerëz të prishur (fasik), të shthurur (maxhin) dhe si thirrës në kryerjen e të ligave (fuxhur)!!

Elhamdulillah, Zoti i Lartësuar e ka shpëtuar Ebu Hanifen, Imam Malikun, Imam Shafi'iun dhe Imam Hanbelin (paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi to) prej kësaj forme injorance dhe prishjeje duke i sjelle ata në jetë para ekzistencës së këtyre ekstremistëve me së paku njëmijë e njëqind vjet differencë, përndryshe ata do ti kishin akuzuar ekstremistët do ti kishin akuzuar ato për mangësi në dije dhe fe.

#### **9. Specifikimi i lehtësimit në fe si diçka e urryer/pështirë dhe kjo duke u bazuar tek shprehja “Ai i cili ndjek lehtësimet e juristëve myslimanë (fukaha) ka dalë prej feje (është zindik)”.**

Nëse me një shprehje të tillë synohet gabimi (khata) në të lehtësuarit e diçkaje atëherë ajo është e gabuar, sepse lehtësimi në fe nuk është më parësor për t'u qortuar/kritikuar se sa ashpërsia në fe. Nëse me këtë shprehje nënkuptohen rrëshqitjet e dijetarëve, qoftë duke dhënë mendime të ashpra ose lehtësuese, atëherë nuk ka asnjë kuptim që kjo shprehje t'i mvishet apo të përdoret vetëm kundrejt atyre që lëshojnë/lehtësojnë në fe dhe ndjekin mendimet lehtësuese të dijetarëve që janë fryt i një

iktilafi jo të pranuar (gajr el-mu'teber). Por, njësoj siç përdoret kundër atyre që ndjekin lehtësimet, një shprehje e tillë duhet shtrirë edhe kundrejt atyre që ndjekin opinionet e ashpra të dijetarëve që janë pasojë e një iktilafi jo të pranuar.

**10. Ndalimi i asaj që nuk është ndaluar asnjëherë më parë dhe shpikja e qendrimeve juridike të ashpra që bien në kundërshtim me atë që ka besuar Umeti që nga fillimi i Islamit deri në ditët tona.**

Kemi dëgjuar për fetvanë që e cilëson të ndaluar mbledhjen e flokëve model topuz nga ana e gruas në pjesën e sipërme të kokës. Kjo në bazë të argumentit të presupozuar që bazohet në hadithin: “Ekzitojnë dy grupe prej banorëve të Xhehenemit të cilët ende nuk i kam parë. Një grup njerëzish që mbajnë kamzhikë që i përngjasojnë bishtave të lopës, me të cilët ata fshikullojnë njerëzit, ndërsa grupi tjetër janë gratë të cilat janë të mbuluara, por të zbuluara (njëkohësisht), dhe që flirtojnë dhe joshin. Kokat e tyre ngjajnë me gungat e devesë. Ato nuk do të hyjnë në Xhenet dhe nuk do ta ndejnë aromën e tij dhe aroma e tij mund të nuhatet prej një distancë shumë të largët, prej shumë miljeve larg”. (Muslimi, 2128). Një gjykim ligjor të tillë, për ndalimin e mbledhjes së flokëve topuz nga ana e grave në kokat e tyre nuk e ka dhënë askush më parë. Një interpretim të tillë të hadithit nuk e ka dhënë askush prej komentuesve të haditheve. [...] Argumentimin e tyre nuk e ka mbeshtetur asnjë fakih, apo jurist, as para dhe as pas tyre. Pastaj, a keni dëgjuar për ndalimin e shprehjes “ue neam bilah” me argumentimin se kjo shprehje është dialektore dhe jo gjuhë letrare? A keni dëgjuar për ata që ndalojnë dërgimin e luleve gjatë vizitës të sëmurit në spital me argumentimin se një veprim i tillë është shpërdorim dhe përngjasim me qafirët? Lista e fetvave të çuditshme është tejet e gjatë. Pastaj pyesim veten se nga erdhi ky ekstremizëm?! Apo pyesim se nga e morën nxënësit e dijes këtë sipërfaqësi në të analizuarit e çështjeve ditunore?

Fund

Përktheu (me përshtatje të lehta)

Rezart Beka

**Date Created**

11/01/2020

**Author**

hatem-el-auni